



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

***RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË
KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS***

Janar – Dhjetor 2024

Ky raport pasqyron funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës. Këtu janë përmbledhur funksionimi i kuvendeve dhe ekzekutivit të komunës; transparenca komunale; zbatimi i obligimeve të komunave nga Programi Kombëtar për MSA; planifikimi, realizimi dhe shpenzimet buxhetore, si dhe jep një pasqyrë të opinioneve të auditorit të përgjithshëm për komunat për vitin paraprak.

Prishtinë, 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORT PËR FUNKSIONIMIN E
KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Janar - Dhjetor 2024

Përmbajtja

Shkurtesat.....	4
Hyrje	5
Metodologjia	6
Përmbledhje ekzekutive	7
FUNKSIONIMI I KOMUNAVE	9
Kuvendi i Komunës	9
Komitetet e Kuvendit të Komunës.....	10
Komitetet ndihmëse dhe Komitetet Konsultative	11
Aktet e kuvendeve të komunave.....	12
Transparenca dhe llogaridhënia komunale	13
Siguria në Bashkësi	15
Mbikëqyrja e komunave	17
AGJENDA EVROPIANE	19
Kriteret politike.....	20
Kriteret ekonomike.....	23
Standardet Evropiane	25
FINANCAT LOKALE.....	30
Planifikimi i të hyrave vetanake	30
Realizimi i të hyrave vetanake	30
Buxheti Komunal për vitin 2024	36
Shpenzimet krahasuar me buxhetimin.....	37
Opinion i auditorit për komunat e Republikës së Kosovës	40
Rekomandimet.....	41

Shkurtesat

AE	Agjenda Evropiane
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
BE	Bashkimi Evropian
EVS	Ekipet Vepruese për Siguri
KK	Kuvendi Komunal
KKSB	Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshilli Lokal për Siguri Publike
LFPL	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
ML	Ministritë e Linjës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
PKZMSA	Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit
PL	Pushteti Lokal
PQ	Pushteti Qendror
PRE	Programi për Reformë Ekonomike
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 - 2026
UA	Udhëzim Administrativ

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, gjatë vitit 2024 është përkushtuar në zbatimin e prioritetëve të saja strategjike në funksion të mbështetjes dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Në vitin 2016 ka hyrë në fuqi Strategjia dhjetëvjeçare për Vetëqeverisje Lokale (2016 – 2026), e cila ofron një vizion të qartë për ecurinë e reformës dhe zhvillimit të pushtetit lokal. Në përputhje me objektivat zhvillimore të saj, janë operacionalizuar aktivitetet dhe janë përcaktuar një sërë masash të kërkuara veçanërisht nga pushteti lokal. Shtyllë kryesore e synuar mbetet qeverisja e mirë në nivel lokal, transparenca komunale, mbikëqyrja dhe kontrolli i ligjshmërisë, efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimeve dhe prioritizimi i obligimeve të komunave nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, për të cilat MAPL është duke punuar ngushtë me nivelin lokal, partnerët, shoqërinë civile dhe akterët tjerë.

Raporti për funksionimin e komunave është dokument që vlerëson progresin e komunave gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024. Ky raport hartohet çdo vit deri me datë 31 Mars dhe i njëjti paraqitet para Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij raporti është të informohen drejtë: Qeveria, Kuvendi i Republikës së Kosovës, komunat, shoqëria civile, qytetarët dhe grupet e tjera të interesit, lidhur me funksionimin dhe shkallën e arritshmërisë së progresit të komunave, por edhe sfidave të hasura gjatë vitit. Raporti ofron konkluzionet lidhur me fushat përkatëse dhe jep rekomandimet specifike për komunat që duhet adresuar në të ardhmen.

Raporti ka këtë strukturë, si vijon:

- Përshkruan funksionimin e kuvendeve të komunave dhe ekzekutivit të komunës;
- Paraqet rezultatet e punës së organeve komunale, me theks të veçantë kuvendit të komunës si organi më i lartë në komunë;
- Analizon fushën e transparencës komunale;
- Shqyrton hapat e komunave në zbatimin e obligimeve nga Programi Kombëtar për MSA;
- Paraqet të dhënat për planifikimin e buxheteve komunale, realizimin e të hyrave dhe shpenzimet buxhetore;
- Jep një pasqyrë të opinioneve të auditorit të përgjithshëm për komunat për vitin paraprak.

Raporti është produkt i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL.

Metodologjia

Ky raport bazohet në të dhënat e mbledhura dhe të analizuara në procesin e monitorimit të komunave nga Departamentet dhe njësitë përgjegjëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL.

Lidhur me metodologjinë e raportit, janë përdorur burime të ndryshme të të dhënave, të siguruara nga: zyrtarët komunal, si dhe informata të tjera të siguruara nga monitoruesit e MAPL-së në terren. Një pjesë e të dhënave janë marrë nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës – SIMFK, Departamenti i Thesarit - MFPT, nga monitorimi i drejtpërdrejtë i komunave, si dhe nga raportet për obligimet e komunave që dalin nga agjenda evropiane. Gjithashtu, të dhënat janë siguruar edhe përmes pyetësorëve të dizajnuar për mbledhjen e të dhënave në fushat përkatëse të paraqitura në raport. Raporti ka një metodologji përshkruese (*deskriptive*) dhe analitike të punës së funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2024.

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2024, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur gjithsej 541 mbledhje, prej te cilave, të rregullta kanë qenë 415, të jashtëzakonshme 55, solemne 68 dhe urgjente 3. Mbledhjet e mbajtura kanë qenë të hapura për publikun, duke u dhënë mundësinë qytetarëve të informohen rregullisht për zhvillimet e politikave lokale, njëkohësisht ato janë transmetuar edhe në ueb faqet zyrtare të komunave përmes kanalit të youtube. Paralelisht me kuvendet, aktivitetin e tyre e kanë zhvilluar edhe komitetet obligative, si dhe komitetet e tjera të themeluara. Sipas të dhënave, janë mbajtur 430 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 406 të Komitetit për Komunitete. Krahës kësaj, gjatë vitit 2024, 3 komuna kanë themeluar komitetet e tjera në 11 fusha përkatëse, si dhe 3 komuna kanë themeluar komitete konsultative, në 5 fusha përkatëse.

Për nga numri i akteve të kuvendeve, gjatë kësaj periudhe janë miratuar 1948 akte, prej të cilave janë 51 rregullore dhe 1897 vendime. Kuvendi i Komunës së Podujevës ka miratuar më së shumti akte (108 akte), i pasuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajit me (98 akte), si dhe Kuvendi i Komunës së Pejës dhe Shtimes me nga 83 akte. Ndërsa, me numrin më të vogël të akteve të miratuara gjatë këtij viti ka qenë Kuvendi i Komunës së Leposaviqit me 7 akte. Kuvendet e komunave kanë ushtruar rolin e tyre mbikëqyrës ndaj ekzekutivit të komunës. Në 30 komuna kryetarët e komunave kanë përmbushur obligimin e tyre ligjor për të raportuar para kuvendit të komunës, madje në 7 komuna, kryetarët kanë raportuar më shumë se dy herë. Në 6 komuna, kryetarët nuk e kanë përmbushur obligimin ligjor për raportim, pasi kanë raportuar vetëm nga 1 herë brenda vitit, ndërsa në 2 komuna (Malishevë dhe Mamushë), kryetarët nuk kanë raportuar fare.

Promovimi i transparencës komunale mbetet një nga çështjet kyçe të qeverisjes demokratike. Gjithsej 29 Komuna kanë përmbushur obligimet ligjore për të mbajtur së paku 2 takime me qytetarët, 31 kanë publikuar ftesat për takime publike me qytetarët, ndërsa 7 komuna nuk kanë përmbushur obligimin ligjor për publikimin e ftesave për takimet publik me qytetarët.

Janë bërë përpjekje të vazhdueshme nga komunat për të përkrahur zbatimin e politikave gjinore, ku sipas të dhënave në 29 komuna numri i grave në pozita menaxheriale është 1002. Krahës tyre, në administratën publike lokale duke përfshirë edhe kuvendin e komunës në 30 komuna numri total i përfaqësimit të grave në administratën publike është gjithsej 4112. Sa i përket raportit statistikor (gjinor) të drejtorëve të drejtorive komunale, në 27 komuna janë 95 drejtoresha. Megjithatë, ka nevojë të ngritet vetëdija e përgjithshme institucionale dhe shoqërore, ashtu që të adresohet edhe një nga rekomandimet kryesore të BE-së për përfshirje të grave në pozita vendimmarrëse. Në 38 komuna janë emëruar vetëm 3 gra nënkryetare dhe në 10 komuna ku duhet të ekzistojë pozita e nënkryetarit për komunitete asnjë grua nuk e ushtron këtë pozitë. Krahës kësaj, janë zgjedhur vetëm 9 gra kryesuese të kuvendeve të komunave: Dragash, Gjakovë, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Obiliq, Prizren, Skenderaj, Vushtrri dhe Zveqan.

Siguria në bashkësi mbetet përgjegjësi e përbashkët institucionale me qëllim të uljes së rreziqeve ndaj jetës dhe sigurisë së qytetarëve. Kufijtë e mbrojtjes policore nuk mjaftojnë për t'u përballur me fenomenet sociale të shumta që mund të ndodhin në bashkësi, për çfarë kërkohet bashkëpunim dhe bashkërendim i të gjitha mekanizmave, përfshirë: komunat, policinë, akterët e shoqërisë civile, qytetarët, mediet, etj. Për këtë arsye, këshillat për siguri në bashkësi janë forume të cilat mund të sjellin ndryshime esenciale në politikat e sigurisë në bashkësi dhe në përcaktimin e prioriteteve në këtë fushë. 16 komuna kanë përmbushur kuotën ligjore për të mbajtur së paku 6 takime në vit, ndërsa komunat që nuk e kanë përmbushur kuotën ligjore por kanë mbajtur takime si vijon: 5 takime kanë

mbajtur komunat: Obiliq, Vushtrri, Graçanicë; 4 takime komunat: Viti, Deçan, Ranillug, Klllokot; 3 takime komunat: Prishtinë, Gjakovë, Shtime dhe Partesh; me nga 2 takime komunat: Mitrovicë e Jugut, Malishevë, Novobërdë dhe Shtërpçë; dhe me nga 1 takim komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë dhe Mamushë; Në komunën e Mitrovicës Veriore edhe pse është themeluar KKSBB, mirëpo nuk është mbajtur asnjë takim. Ndërsa në 3 komuna (Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok) KKSBB-të nuk janë themeluar nga kuvendet e komunave.

Gjatë vitit 2024, procesit të vlerësimit të ligjshmërisë u janë nënshtruar gjithsej 1948 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave (51 rregullore dhe 1897 vendime). Nga gjithsej 1948 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 1098 akteve, ndërsa 850 akte janë shqyrtuara nga ministrinë e linjës.

Kosova është duke kaluar nëpër një stad të rëndësishëm të zhvillimeve dhe ndërtimit të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian. Marrëveshja për Stabilizim Asociim e nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe BE ka hyrë në fuqi më 1 prill të vitit 2016, derisa Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, i cili përbën dokumentin kryesor nacional të politikave për aderim në BE. Komunitat si aktor të rëndësishëm shtetëror kanë barrën e tyre të përgjegjësisë në raport me përmbushjen e masave të kërkuara në fushën e agjendës evropiane. Programi i komunave në këtë fushë është strukturuar në bazë të 3 kriterëve kryesorë të integritit: a) Politike, b) Ekonomike, c) Standardeve Evropiane. Bazuar nga të dhënat e ofruar nga komunitat, gjatë vitit 2024 komunitat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 54% të aktiviteteve në fushën e kriterëve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kriterëve ekonomike, komunitat kanë arritur që t'i përmbushin 70% të kriterëve dhe në fushën e standardeve evropiane ato kanë realizuar 62% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2024 është 64%.

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, Komunitat e Republikës së Kosovës për vitin 2024 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 841,040,645.99€ e buxhetit të planifikuar në vlerë prej 784,532,455.39€ ose 93.28 % e buxhetit. Për vitin 2024, planifikimi i të hyrave vetanake është në vlerë prej 105,523,577.00€, ku krahasuar me të hyrat e planifikuara për vitin 2023, në vlerë prej 98,519,261.00€, del që planifikimi për vitin 2024 ka qenë më i lartë për 7,004,316.00€, ose shprehur në përqindje 7.10%.

FUNKSIONIMI I KOMUNAVE

Në këtë pjesë kemi pasqyruar funksionimin e organeve të komunave të Republikës së Kosovës në përmbushjen e obligimeve të tyre ligjore që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të cilat përcaktojnë kompetencat e vetëqeverisje lokale. Më theks të veçantë, kjo pjesë fokusohet në monitorimin e funksionimit të kuvendeve të komunave, përmbajtja e të cilave garanton qëndrueshmërinë e organeve komunale, respektimin e procedurave ligjore, respektimin e ligjshmërisë, efikasitetin, transparencën, bashkëpunimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin.

Kuvendi i Komunës

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës në nivel të qeverisjes lokale dhe njëkohësisht mbikëqyrë ofrimin e shërbimeve nga ekzekutivi i komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kuvendi mban mbledhje të rregullta në mënyrë që të kryej funksionet e tij të përcaktuara me ligjin për vetëqeverisje lokale dhe akte të tjera nënligjore.


Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar minimumin e mbledhjeve të cilat duhet ti mbaj kuvendi i komunës, brenda një viti. Ky ligj ka përcaktuar mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve në vit të kuvendit të komunës, 5 prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit.

Në Republikën e Kosovës në këtë periudhë kanë funksionuar kuvendet e 38 komunave, të cilat kanë mbajtur mbledhje rregullisht.

Gjatë këtij viti, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur gjithsej 541 mbledhje. *Prej tyre, të rregullta kanë qenë 415, të jashtëzakonshme 55, solemne 68 dhe urgjente 3.*

- **Mbledhjet e rregullta, 415;**
- **Mbledhjet e jashtëzakonshme, 55;**
- **Mbledhjet solemne, 68;**
- **Mbledhjet urgjente, 3.**

Në vijim përmes grafikunit kemi paraqitur numrin e mbledhjeve të mbajtura nga kuvendet e komunave:



Diagrami 1: Numri i mbledhjeve të mbajtura nga kuvendet e komunave.

Siç shihet edhe nga grafikonit i paraqitur më lartë, të gjitha komunat kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve të kuvendit të komunës, ashtu siç është përcaktuar më Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.

Lidhur me njoftimin për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, komunat në përgjithësi kanë kryer obligimin ligjor në raport me MAPL-në si dhe me publikun, duke informuar në vazhdimësi për mbajtjen e mbledhjeve, sipas afatit të përcaktuar ligjor, si dhe kanë dërguar edhe materialet për mbledhje, siç është përcaktuar me nenin 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Mbarëvajtja e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, gjatë kësaj periudhe ka qenë konform dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, mirëpo janë evidentuar edhe raste kur një pjesë e anëtarëve të kuvendeve kanë lëshuar mbledhjet, ku janë ndërpre mbledhjet për shkak të mungesës së kuorumit në komunat: Prishtinë, Ferizaj, Kamenicë Podujevë, Glogoc, Gjakovë, Kaçanik, Gjilan, Klinë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Shtime, Malishevë, Vushtrri dhe Prizren.

Komitetet e Kuvendit të Komunës


Kuvendet e komunave bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, si komitetet të përhershme. Komiteti për Politikë dhe Financa, themelohet më përbërje nga anëtarët e kuvendit të komunës, dhe si mekanizëm këshillëdhënës i kuvendit të komunës, shqyrton paraprakisht të gjitha çështjet me karakter fiskale dhe financiare, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën afatmesme buxhetore, planit vjetor të prokurimit, rregulloret e tatimit në pronë dhe rregulloret për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, si dhe të gjitha çështjet e tjera që shqyrtohen dhe miratohen në kuvendin e komunës.

Komiteti për Komunitete, përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, si dhe përfaqësuesit e komuniteteve jashtë kuvendit. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Komiteti për Komunitete i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të

avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuatë të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Gjatë kësaj periudhe komitetet e përhershme kanë qenë funksionale dhe kanë mbajtur gjithsej 836 takime. Nga këto, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 430 takime, ndërsa Komiteti për Komunitete 406 takime.

Në vijim përmes grafikoni kemi paraqitur numrin e takimeve të mbajtura nga komitetet e përhershme të kuvendeve të komunave:



Diagrami 2: Numri i mbledhjeve të komiteteve të përhershme.

Duke marrë parasysh se Komiteti për Politikë dhe Financa është organ i përhershëm i Kuvendit të Komunës, përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve dhe çështjeve të buxhetit, rrjedhimisht puna e këtij komiteti përfaqëson edhe rekomandimet për kuvendin e komunës. Mbi bazën e kësaj, ky komitet takimet duhet t'i mbajë para mbledhjeve të kuvendit të komunës, duke marrë parasysh funksionet e përcaktuara edhe me Rregulloret e Punës së Kuvendeve të Komunave.

Komiteti për Komunitete, është komiteti i dytë i përhershëm i kuvendit të komunës, detyrë e të cilit është shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim, shqyrtimi i të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Ai gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuatë të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Komitetet ndihmëse dhe Komitetet Konsultative

Kuvendi i komunës mund të themelojë komitete të tjera profesionale nëse e sheh të nevojshme dhe të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë e veta për sektor specifik si: arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Për të rritur pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe grupeve të interesuara në procesin e vendimmarrjes lokale, kuvendi i komunës themelon edhe komitete konsultative brenda sektorëve përkatës qeverisës. Bazuar në nenin 73, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe U.A. (MAPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit,

Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komuna, Kuvendi i Komunës, është i obliguar të themelojë edhe komitetet konsultative, me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Sipas të dhënave gjatë vitit 2024, 3 komuna kanë themeluar komitete konsultative, në 5 fusha përkatëse si në vijim: arsim, kulturë, rini dhe sport, planifikimi hapësinor, zhvillimi ekonomik lokal, shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe shërbime emergjente.


Sa i përket Komiteteve tjera ndihmëse, vetëm 3 komuna kanë themeluar dhe kanë qenë funksionale komitetet, ku kanë mbuluar 11 fushat si në vijim: shëndetësi dhe mirëqenie sociale, arsim, kulturë, rini dhe sport, planifikim hapësinor, bujqësi, zhvillim ekonomik dhe shërbime publike.

Aktet e kuvendeve të komunave

Kompetencë dhe funksion themelor i kuvendit të komunës, është miratimi i politikave lokale përkatësisht i akteve nënligjore të komunës, si rregulloreve dhe vendimeve për zbatimin e legjislacionit sektorial që prek kompetencat e komunave. Kuvendi miraton Statutin dhe Rregulloren e Punës, vendime, rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, miraton buxhetin, themelon komitetet, miraton çështje financiare, zgjedh kryesuesin e kuvendit të komunës dhe nënkryetarët e komuniteteve, si dhe akte të nevojshme për funksionimin efikas të komunës.

Gjatë kësaj periudhe të gjitha kuvendet e komunave kanë qenë funksionale. Komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka qenë i rregullt, dërgimi i akteve të kuvendit të komunës ka qenë i rregullt dhe në afatin e përcaktuar ligjor. Gjatë këtij viti, kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 1948 akte. Nga gjithsej 1948 akte të miratuara, prej tyre 51 janë rregullore, dhe 1897 vendime. Në vijim përmes grafikoni kemi paraqitur numrin e akteve të miratuara nga kuvendet e komunave:

Aktet e Kuvendeve të Komunave




Diagrami 3: Numri i akteve të miratuara në kuvendet e komunave.

Nga grafikoni, vërejmë se Kuvendi i Komunës së Podujevës ka miratuar më së shumti akte (108 akte), i pasuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajit me (98 akte), si dhe Kuvendi i Komunës së Pejës dhe Shtimes me nga 83 akte. Ndërsa, me numrin më të vogël të akteve të miratuara gjatë këtij viti ka qenë Kuvendi i Komunës së Leposaviqit me 7 akte.

Transparenca dhe llogaridhënia komunale

Raportimi i kryetarit - Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar obligimin e kryetarit të komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në bazë të paragrafit j) të nenit 58 të këtij ligji, kryetari i komunës është i obliguar të raportojë para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i Komunës. Të dhënat flasin se gjatë vitit 2024 numri i raportimeve të 36 kryetarëve të komunave para kuvendit ka qenë 93, të cilat janë paraqitur, si vijon:



Diagrami 4: Numri i raportimeve të kryetarëve para kuvendeve të komunave.


Sipas diagramit më lartë në 30 komuna, kryetarët kanë përmbushur obligimin e tyre ligjor për të raportuar para kuvendit të komunës, madje në 7 komuna, kryetarët kanë raportuar më shumë se dy herë. Në 6 komuna, kryetarët nuk e kanë përmbushur obligimin ligjor për raportim, pasi kanë raportuar vetëm nga 1 herë brenda vitit (Prishtinë, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë Veriore, Novobërdë dhe Ranillug). Në 2 komuna, kryetarët nuk kanë raportuar fare (Malishevë dhe Mamushë).

Forma të tjera të llogaridhënies janë edhe përmes pyetjeve të drejtpërdrejta dhe me shkrim të parashtruara nga anëtarësia e kuvendit ndaj ekzekutivit. Për të mundësuar bashkëpunimin ndërmjet kuvendit dhe ekzekutivit të komunës, është i nevojshëm shtimi i prezencës së rregullt të kryetarëve dhe drejtorëve në mbledhjet e kuvendeve të tyre. Një komunikim i vazhdueshëm i të dy organeve i kontribuon demokracisë lokale, rritë cilësinë e vendimmarrjes dhe ligjshmërisë, zgjeron rrethin e aktorëve përgjegjës për hartimin e politikave të zbatueshme me interes të përgjithshëm, si dhe ndërton segmente të llogaridhënies brenda administratës komunale.

Takimet publike me qytetarë - Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është parim bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë. Komunat janë të obliguara të vënë në funksion standarde të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale neni 68.1, dhe udhëzimin administrativ Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, dhe atë përmes: takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik, përfshirjes aktive të qytetarëve,

grupeve të interesit, tryezave të përbashkëta, përdorimit të sistemeve elektronike të informacionit, si dhe metoda të tjera me të cilën transparenca do të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale çdo komunë mbanë së paku dy herë në vit takime publike në të cilat mund të merr pjesë secili qytetarë apo organizatë me interes në komunë. Njëra nga takimet duhet të mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të ngritin çështje të ndryshme dhe të japin propozime para organeve komunale. Në vitin 2024, organizimi i takimeve publike gjithëpërfshirëse me qytetarë në komuna ka qenë si në vijim:



Diagrami 5: Numri i takimeve publike me qytetarë.

Nga diagrami shohim se gjithsej 29 Komuna kanë përmbushur obligimet ligjore për të mbajtur së paku 2 takime me qytetarët, 4 komuna (Lipjan, Obiliq, Junik dhe Partesh) kanë përmbushur pjesërisht obligimin ligjor duke mbajtur vetëm nga 1 takim publik me qytetarët, ndërsa 5 komuna (Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan, Novobërdë dhe Mamushë), nuk kanë mbajtur asnjë takim publik me qytetarët.

Përveç këtyre takimeve, komunat kanë mbajtur edhe takime të tjera me qytetarë në lokacione më të vogla, lagje, fshatra dhe vendbanime të tjera. Forma të tilla të organizimit, janë bërë me rastin e diskutimit të projekt-rregulloreve, planeve dhe çështjeve buxhetore, të cilat qytetarëve u kanë mundësuar ofrimin e sugjerimeve, propozimeve dhe kërkesave të tyre.

Komunat pos takimeve publike me qytetar ashtu siç përcaktohet më nenin 68.1 kanë mbajtur edhe konsultime publike me qytetarë për të diskutuar çështjet që kanë të bëjnë më miratimin e rregulloreve komunale, planet zhvillimore, hartat zonale kornizën afatmesme buxhetore. Edhe pse komunat kanë organizuar konsultime publike me qytetarët, pjesëmarrja e tyre në këto takime ka qenë e vogël. Mbajtja e takimeve publike dhe formave të tjera të konsultimit publik duhet të jetë proces i vazhdueshëm në të gjitha fazat e politikbërjes në komunë.

Ueb-faqet zyrtare të komunave – është një nga mekanizmat për të mbajtur të informuar qytetarët lidhur me aktivitetet e organeve komunale. Funksionimi dhe përdorimi i faqeve zyrtare të komunave rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2015 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike, i cili i obligon të gjitha institucionet publike të japin informacione për punën e organeve të tyre, shërbimet e ofruara, përmbajtjes dhe përditësimit të dokumenteve zyrtare, informacionet për përgjegjësitë e njësive organizative të komunave, dokumentet financiare, prokurimit etj.

Po ashtu, informacioni i publikuar në ueb faqe duhet të jetë në përputhje me kërkesat dhe standardet gjuhësore. Përderisa në vitin 2018 është realizuar projekti për ridizajnimin e ueb-faqeve të të gjitha komunave, në vitin 2019 ndryshimet e tyre kanë sjellë integrimin e sistemit të intranetit në ueb-faqet e komunave, ku qytetarët mund të adresojnë kërkesat për pajisje me dokumentet e gjendjes civile. Gjithashtu, në këtë drejtim është krijuar qasja në gjurmimin e lejeve të ndërtimit, paraqitjes së kërkesave të qytetarëve në fushën e sigurisë në bashkësi, si dhe transmetimi online i mbledhjeve të kuvendëve të komunave. Struktura e ueb-faqeve mundëson qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në të gjitha dokumentet relevante të destinuara për publikim. Përditësimi i të dhënave të komunave është bërë në vazhdimësi, edhe pse ka vend për përmirësim sidomos në publikimin e akteve normative në gjuhët zyrtare.

Gjatë kësaj periudhe kuvendet e komunave kanë të publikuara 4920 akte nga 26 komuna ose 68%, ndërsa 12 komuna ose 32% e tyre nuk kanë publikuar asnjë akt. Nga gjithsejtë 38 komuna, 34 prej tyre kanë publikuar 1539 vendime të kuvendit të komunës, ndërsa 4 komuna nuk ka publikuar asnjë vendim. Janë publikuar 59 rregullore, 27 komuna kanë publikuar rregullore, ndërsa 11 komuna nuk kanë publikuar asnjë rregullore për vitin 2024.

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2024, janë publikuar 425 ftesa për mbledhje të kuvendit komunal nga 31 komuna, ndërsa 7 komuna nuk kanë publikuar asnjë ftesë për mbledhjet e kuvendit komunal. Nga 38 komuna janë publikuar 328 procesverbale të kuvendëve të komunave, prej tyre 9 komuna nuk kanë publikuar asnjë procesverbal, ndërsa 29 komuna kanë publikuar procesverbale të kuvendit. Nga totali 38 i komunave, 26 komuna kanë publikuar 324 procesverbale të Komitetit për Politikë dhe Financa, ndërsa 12 komuna tyre nuk kanë publikuar asnjë procesverbal. Gjithashtu, 38 komuna kanë publikuar në total 145 procesverbale të Komitetit për Komunitete, prej tyre 21 komuna kanë publik procesverbale të Komitetit për Komunitete, ndërsa 17 komuna nuk kanë publikuar asnjë procesverbal.

Sa i përket transparencës buxhetore, prej 38 komuna 30 ose rreth 79% e tyre kanë publikuar planin e buxhetit për vitin 2024, ndërsa 8 komuna ose rreth 13% prej tyre nuk kanë publikuar planin e buxhetit për vitin 2024. Komunitat të cilat nuk kanë publikuar planin e buxhetit janë: Klllokot, Ranillug, Shtërpçë, Zubin Potok, Zveqan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut dhe Mamushë.


Sa i përket transparencës në prokurim për vitin 2024, 27 komuna kanë publikuar planin e prokurimit, ndërsa 11 komuna nuk kanë publikuar planin e prokurimit, si: Fushë Kosovë, Istog, Kaçanik, Klllokot, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Zubin Potok, Zveqan, Mitrovicë e Veriut.

Ndërsa planin e konsultimeve publike e kanë publikuar 21 komuna, 17 komuna (Fushë Kosovë, Gjilan, Graçanicë, Istog, Kaçanik, Klllokot, Novobërdë, Partesh, Pejë, Prishtinë, Ranillug, Shtërpçë, Zubin Potok, Zveqan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut dhe Mamushë) nuk e kanë publikuar këtë plan.

Siguria në Bashkësi

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB është organ këshillëdhënës ndërsektorial, përgjegjës për çështjet e sigurisë në nivel lokal. Funksionimi i këshillave për siguri në bashkësi rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Për shkak të normimit të standardeve të funksionimit të tyre, ka pasur ngritje të vetëdijes institucionale për rëndësinë e KKSBB-ve, duke bërë që angazhimi i komunave të fokusohet edhe në çështjet e përgjithshme të sigurisë, përfshirë këtu: vetëdijesimin e qytetarëve për natyrën e krimeve, parregullsive dhe sjelljeve të dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave të qytetarëve dhe përfaqësimit të pikëpamjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve për çështjet e krimit. KKSBB,

është i themeluar në 35 komuna, dhe gjatë vitit 2024 janë mbajtur gjithsej 153 takime. Në vijim përmes grafikoni kemi paraqitur mbajtjen e takimeve të KKS-së sipas komunave:



Diagrami 6: Numri i takimeve të KKS-së sipas komunave.

Sipas të dhënave të paraqitura më lartë, 16 komuna kanë përmbushur kuotën ligjore për të mbajtur se paku 6 takime në vit. Për nga numri i takimeve, më aktiv ka qenë KKS në Komunën e Rahovecit (8 takime) dhe Hanit të Elezit (7 takime); me 6 takime të mbajtura komunat: Skenderaj, Kamenicë, Podujevë, Gllogoc, Kaçanik, Suharekë, Gjilan, Pejë, Istog, Klinë, Lipjan, Prizren, Dragash dhe Junik; ndërsa komunat që nuk e kanë përmbushur kuotën ligjore por kanë mbajtur takime si vijon: 5 takime kanë mbajtur komunat: Obiliq, Vushtrri, Graçanicë; 4 takime komunat: Viti, Deçan, Ranillug, Klokot; 3 takime komunat: Prishtinë, Gjakovë, Shtime dhe Partesh; me nga 2 takime komunat: Mitrovicë e Jugut, Malishevë, Novobërdë dhe Shtërpçë; dhe me nga 1 takim komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë dhe Mamushë; Në komunën e Mitrovicës Veriore edhe pse është themeluar KKS, mirëpo nuk është mbajtur asnjë takim. Ndërsa në 3 komuna (Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok) KKS-të nuk janë themeluar nga kuvendet e komunave.

Problemet më të shpeshta të cilat janë trajtuar gjatë kësaj periudhe të raportimit, si dhe iniciativat për realizimin e projekteve për siguri në bashkësi gjatë vitit 2024, janë: aksidentet në trafik; planet operative të ndërmarra nga Policia e Kosovës për ushtrimin e kontrollit më të rreptë të trafikut rrugor, për të zvogëluar aksidentet me fatalitet dhe sfidat; identifikimi i zonave të rrezikshme në trafik (ku ndodhin më shumë aksidente) si dhe përgatitja për pritjen e bashkatdhetarëve; çështjet e sigurisë në komunë; qentë endacak; infrastruktura; kontrolli i pyjeve; përgatitjet për fushatën e korrije - shirjeve në territorin e Komunës; fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera; zjarret në sezonin e verës; verifikimi i aparateve për fikjen e zjarreve; menaxhimi i situatës nga vërshimet e fundit dhe zhvillimi i aktiviteteve tjera; ruajtja dhe mbrojtja e ambientit; situata në Komunë me ndriçim, parkingje, mbeturina dhe pastrim të rrugëve; siguria në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme; abuzimi me fëmijë të moshës rinore dhe adoleshentë; bullizimi në shkolla; dhuna psikike, fizike dhe seksuale në shkolla; trajtimi i objekteve të braktisura dhe objekteve të vjetra; e drejta për punë; puna në sektorin privat; orari i punës dhe kontratat e punës; kthimi i qytetarëve me banim të përkohshëm jashtë Kosovës, çështja e sigurisë dhe shërbimet Administrative;

Iniciativa që duhet ndërmarrë: miratimi i planit të veprimit dhe planit dinamik të punës; vlerësim i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunave; Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimi

i planit për siguri në shkolla; Poashtu Informata nga Institucionet siç janë: Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, KFOR, FSK, Arsim, Përfaqësues të komuniteteve, Këshillat Lokal të Sigurisë Publike të Prishtinës, etj. Ndërsa sfidat më të shpeshta me të cilat ballafaqohet Këshilli Komunal në Siguri në Bashkësi janë: gjetja e fondeve për realizimin e projekteve të propozuara nga KKSBB-të; pagesa e anëtarëve të KKSBB-së; ndotja e ambientit; vendosja e nënkalimeve në rrugët kryesore sidomos afër shkollave; siguria në trafik; lirim i hapësirave publike; qentë endacak, etj.

Këshilli Lokal për Siguri Publike është themeluar në 23 komuna ndërsa në 8 komuna (Shtërpçë, Deçan, Dragash, Hani Elezit, Skenderaj, Shtime, Ranillug, Novobërdë) nuk janë themeluar KLSP. Prej tyre janë 17 komuna që kanë mbajtur gjithsej 84 takime të KLSP-ve.

Ekipi Veprues për Siguri në 12 komuna kanë mbajtur gjithsej 39 takime, ndërsa 19 komunat (Shtërpçë, Prizren, Gllogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Hani Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Jugore, Shtime, Ranillug, Mitrovicë Veriore, Gjilan, Ferizaj, Novobërdë, Kamenicë) nuk është mbajtur asnjë takim.

Këshillat e fshatrave janë themeluar në 24 komuna (Pejë, Junik, Prizren, Gllogoc, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Hani Elezit, Graçanicë, Mitrovicë Jugore, Malishevë, Podujevë, Viti, Ranillug, Rahovec, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan, Kamenicë). Prej tyre janë 15 Komuna (Pejë, Junik, Prizren, Gllogoc, Deçan, Kaçanik, Mitrovicë Jug, Podujevë, Viti, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Kamenicë) që kanë mbajtur gjithsej 363 takime të këshillave.


Mbikëqyrja e komunave

MAPL është autoriteti mbikëqyrës i komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar ato.¹ Procesi i shqyrtimit administrativ të akteve komunale është rregulluar më LVL, dhe Rregulloren (QRK) NR-10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - Gjatë vitit 2024, procesit të vlerësimit të ligjshmërisë u janë nënshtruar gjithsej 1948 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave. Nga gjithsej 1948 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave (51 rregullore dhe 1897 vendime), MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 1098 akteve. Në vijim, përmes diagramit kemi paraqitur të dhënat lidhur me procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunave nga MAPL:

¹ Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Kreu X, Nenet 75 dhe 76.

Shqyrtimi i ligjshmërisë nga MAPL




Diagrami 7: Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga MAPL.

Siç shihet edhe nga diagrami i paraqitur më lartë, MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 1098 akteve, ku 654 akte janë konfirmuar të ligjshme, dhe 88 akte janë konstatuar të kundërligjshme, nga të cilat komunat pas marrjes së kërkesës për rishqyrtim kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 70 akte ashtu siç është kërkuar nga MAPL, 11 akte janë shfuqizuar nga komuna, 1 akt është brenda afatit për rishqyrtim, ndërsa 6 akte kanë mbetur të pa rishqyrtuara, të cilat janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë për t'i kundërshtuar në gjykatë, si dhe 356 akte të pranuar nuk i nënshtrohen shqyrtimit të ligjshmërisë.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga ministritë e linjës - Nga gjithsej 1948 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave (51 rregullore dhe 1897 vendime), Ministritë e Linjës, kanë shqyrtuar ligjshmërinë e 850 akteve. Në vijim, përmes diagramit kemi paraqitur procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunave nga Ministritë e linjës:

Shqyrtimi i ligjshmërisë nga Ministritë e Linjës




Diagrami 8: Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga ministritë e linjës.

Siç shihet edhe nga diagrami i paraqitur më lartë, ministritë e linjës kanë shqyrtuar 850 të akteve. Nga këto, 732 janë konfirmuar të ligjshme ndërsa 118 akte janë konstatuar të kundërligjshme. Nga 118 akte të konstatuara të kundërligjshme, komunat kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 82 akte konform kërkesës për rishqyrtim, 23 janë shfuqizuar nga komuna, 2 akte janë brenda afatit ligjor për rishqyrtim dhe 11 akte janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë.

AGJENDA EVROPIANE

Zbatimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asociim është një ndër prioritetet më të rëndësishëm të Republikës së Kosovës e cila është nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian dhe ka hyrë në fuqi me 1 prill të vitit 2016. Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 mars 2016 ka aprovuar Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, dokument i cili i obligon institucionet shtetërore t'i kryejnë të gjitha obligimet e kërkuara në këtë proces. Komunat si nivel i veçantë i institucioneve të administratës shtetërore kanë përgjegjësin e tyre në raport me përmbushjen e masave të kërkuara në fushën e agjendës evropiane. Në këtë drejtim Ministria e Pushtetit Lokal, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në këtë fushë me nivelin lokal të qeverisjes, gjatë vitit 2024 ka ndërmarrë një sërë veprimesh për adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane, të cilat janë paraqitur në këtë raport. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 kanë raportuar 31 komuna të Republikës së Kosovës ndërsa 6 komuna (Gjakovë, Istog, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Mamushë dhe Kllokot) gjatë kësaj periudhe nuk kanë raportuar.

- Programi i komunave në këtë fushë është strukturuar në bazë të 3 kriterëve kryesore të integritimit: a) Kriteret Politike, b) Kriteret Ekonomike dhe c) Standardet Evropiane.
- Komunat kanë ofruar informatat në këtë aspekt duke u bazuar në planet e përgjithshme të hartuara nga MAPL, të cilat përfshijnë obligimet më kuadër të: Programit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së, sfidave të qeverisjes lokale të identifikuar nga Raporti i Vendit dhe dokumentet e tjera relevante.
- Bazuar nga të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë vitit 2024 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 54% të aktiviteteve në fushën e kriterëve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kriterëve ekonomike, komunat kanë arritur që t'i përmbushin 76% të kriterëve dhe në fushën e standardeve evropiane ato kanë realizuar 62% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2024 është 64%, si vijon:



Diagrami 9: Përmbushja e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane.


Kriteret politike

Stabiliteti i institucioneve në qeverisjen demokratike, respektimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve jo shumicë, është një nga kapitujt kryesor të një vendi që duhet përmbushur në raport me agjendën e integritimit evropian. Përmbushja e kriterëve politike është obligim i cili duhet përmbushur nga Kosova si vend kandidat potencial për anëtarësim në BE. Në këtë pjesë të raportit janë përfshirë të dhënat për aktivitetet e komunave në fushën e kriterëve politike, me fokus: fuqizimin e administratës publike lokale, bashkëpunimin me shoqërinë civile, luftën kundër terrorizmit, luftën kundër korrupsionit, të drejtat e njeriut dhe komuniteteve jo shumicë, barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat pronësore, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, si dhe fushat e tjera respektive.

Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kriterëve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë aktivitete të shumta për sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën e pushtetit lokal, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, 25 komuna kanë hartuar Programin e trajnimeve, ndërsa në 6 komuna (*Shtërpcë, Deçan, Podujevë, Ranillug, Mitrovica e Veriut, Obiliq*) nuk është hartuar programi i trajnimeve për periudhën raportuese.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave publike në fushën e administratës, të dhëna tregojnë se nga 31 komuna raportuese në 18 komuna (*Pejë, Junik, Prizren, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Shtime, Malishevë, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Lipjan*) është hartuar Strategjia për Komunikim me Publikun ndërsa në 13 (*Shtërpcë, Glogoc, Dragash, Mitrovica e Jugut, Podujevë, Viti, Ranillug, Mitrovica e Veriut, Vushtrri, Novobërdë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Obiliq*) nuk është hartuar.



Diagrami 10: Programi i trajnimeve dhe strategjia për komunikim me publikun.

Po ashtu planin vjetor të komunikimit deri më tani 23 komuna e kanë hartuar (Pejë, Junik, Prizren, Gllogoc, Deçan, Rahovec, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Mitrovica e Jugut, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Ranillug, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suhareke, Lipjan, Kamenicë), ndërsa 8 komuna (Shtërpçë, Dragash, Prishtinë, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovica e Veriut, Novobërde, Fushë Kosovë) ende nuk kanë hartuar.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit përcakton se në çdo komunë, përgjegjëse për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësia/zyrtari për komunikim publik, në përputhje me këtë deri më tani në 29 komuna është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Drenas, Pejë, Hani i Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Klokot, Podujevë), ndërsa në 4 komuna nuk është caktuar ende zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik. Sa i përket zbatimit të këtij udhëzimi, 28 komuna e zbatojnë plotësisht (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Gllogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovica e Jugut, Shtime, Malishevë, Podujevë, Ranillug, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suhareke, Novobërdë, Lipjan, Fushe Kosovë, Kamenicë), 1 komunë e zbaton pjesërisht (Prishtinë), ndërsa 2 komuna nuk e zbatojnë fare (Viti, Mitrovicë e Veriut).

Nga të dhënat e ofruara gjatë raportimit shohim se komunat në vazhdimësi kanë përkrahur shoqërinë civile duke i ofruar mbështetje dhe bashkëpunim. Nga të dhënat e pranura një numër i konsiderueshëm i komunave kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. Në 26 komuna (*Prishtinë, Rahovec, Gllogoc, Viti, Graçanicë, Skenderaj, Pejë, Shtime, Podujevë, Prizren, Deçan, Malishevë, Klinë, Shtërpçë, Hani i Elezit, Mitrovicë e Jugut, Dragash, Junik, Gjilan, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë*) janë ndarë buxhet në vlerë prej 9,634,249.02 euro. Në 4 komuna (*Ranillug, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Obiliq*) nuk është ndarë buxhet, ndërsa 1 komunë (Kaçanik) nuk ka ofruar të dhëna. Me këtë mbështetje financiare janë përkrahur OJQ me 1211 projekte.

Për nxitjen dhe stimulimin e aplikimit të OJQ-ve në projekte komunale komunat kanë ndërmarr edhe veprime si: *informimi në radio lokale, rrjete sociale dhe thirrje në ueb faqe të komunave, organizime të takimeve informuese për procedurat e aplikimit, ofrimi i ndihmës në plotësimin e dokumentacionit aplikues për gupet e OJQ-ve të cilat janë të marginalizuara, trajtim i barabartë dhe mos diskriminim i aplikuesve etj.* Komunat gjithashtu kanë përkrahur edhe projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Në 14 komuna (*Pejë, Shtërpçë, Prizren, Dragash, Prishtinë, Graçanicë, Shtime, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë*) janë përkrahur 28 projekte, për mbrojtjen e komuniteteve pakicë në vlerë prej 220,250.00 euro. Poashtu, në 25 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Gllogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë e Jugut, Shtime, Podujevë, Viti, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) është bërë publikimi i thirrjeve dhe përfituesve në ëeb faqet. Në 4 komuna (Malishevë, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Obiliq) nuk e kanë bërë, ndërsa për 2 Komuna (Ranillug, Novobërdë) nuk ka të dhëna.

Një ndër objektivat më specifike e cila buron nga Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm është edhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve me qëllim të identifikimit të hershëm të faktorëve dhe proceseve të radikalizmit. Lidhur me këtë 11 komuna (Junik, Gllogoc, Deçan, Mitrovicë e Jugut, Malishevë, Podujevë, Partesh, Gjilan, Vushtrri, Obiliq, Lipjan) në bashkëpunim nivelin qendror dhe donatorë

kanë organizuar trajnime për zyrtarët komunal të arsimit, mësuesit, dhe menaxhmentin e shkollave për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm kurse në 20 komuna (Pejë, Shtërpçë, Prizren, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Shtime, Viti, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Ferizaj, Suharekë, Novobërdë, Fushë Kosovë, Kamenicë) nuk janë organizuar.

Zbatimi i strategjisë nacionale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si dhe strategjisë kundër terrorizmit është zgjeruar edhe në nivelin lokal të administratës. Për mbështetjen dhe parandalimin e luftës kundër terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, janë 17 komuna (Junik, Gllogoc, Deçan, Mitrovicë e Jugut, Malishevë, Podujevë, Partesh, Gjilan, Vushtrri, Obiliq, Lipjan) që kanë ndërmarrë veprime konkrete për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpijë në ekstremizëm të dhunshëm si: *takime të rregullta përmes këshillave lokale dhe imamëve të xhamive lokale, takime me nxënës të shkollave të ndryshme, janë krijuar hapësirat e sigurta në shkolla për nxënësit që të bëjnë pyetje privatisht rreth çështjeve të ndjeshme sociale, fushata vetëdijesuese me qytetarët, aktivitete në terren, diskutime gjatë takimeve të rregullta me anëtarët e KKS-së, takime me të rinj, gra dhe strukturat arsimore me qëllim të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në rritjen e ekstremizmit me radikalizëm etj.* Ndërsa në 14 komuna (Pejë, Shtërpçë, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Ranillug, Mitrovica e Veriut, Shtime, Ferizaj, Suharekë, Novobërdë, Fushë Kosovë) nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim. Në 30 komuna nuk ka pasur raste të paraqitura në Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. 1 komunë (Gjilan) është paraqitur 1 rast.

Më qëllim të luftimit të korrupsionit, komunat në vazhdimësi kanë deklaruar rastet e konfliktit të interesit. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, në 26 komuna nuk ka pasur asnjë rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal, ndërsa në 5 Komuna (Gllogoc, Prishtinë, Klinë, Podujevë, Vushtrri) janë paraqitur 12 raste të raportuar të konfliktit të interesit nga zyrtarët. Sa i përket anëtarëve të kuvendit, që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës në 3 komuna (Rahovec, Klinë, Vushtrri) janë paraqitur 36 raste, ndërsa në 28 Komuna nuk ka pasur raste të tilla.

Për të përmirësuar aspektet operacionale të punës në administratë, përgjegjësinë vendimmarrëse, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve, komunat kanë hartuar Planet Lokale për Integritet. Në 27 komuna është hartuar ky plan, ndërsa në 4 komuna (Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Ferizaj, Fushë Kosovë) nuk është hartuar ky Plan gjatë vitit 2024. Zyrtarin që raporton për Planin Lokal të Integritetit nga 31 komuna raportuese 27 komuna kanë caktuar, ndërsa 4 komuna (Shtërpçë, Ranillug, Mitrovica e Veriut, Fushë Kosovë) nuk e kanë caktuar ende.

Sa i përket implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, për krijimin e qasjes për shërbimin në gjuhët zyrtare janë 22 komuna të cilat kanë ndërmarrë veprimet si: organizim i trajnimeve, kurse për gjuhen serbe dhe shqipe, janë punësuar zyrtarë për përkthim, ofrohen shërbime simulante nëpër të gjitha takimet zyrtare, materialet e organeve komunale përkthehen të gjitha në gjuhë zyrtare, shpërndahen broshura të ndryshme për promovimin e të drejtave gjuhësore për të gjitha komunitete etj. ndërsa 5 komuna (Skenderaj, Shtime, Podujevë, Mitrovicë e Veriut, Gjilan) nuk kanë ndërmarrë veprime, në 4 komuna (Klinë, Malishevë, Ranillug, Partesh) janë ndërmarrë veprime të pjesshme ose janë në proces të përmirësimit të kësaj çështjeje. Ashtu siç parashihet në Ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe në rregulloret komunale për gjuhët zyrtare, në 27 komuna bëhet publikimi i akteve komunale në gjuhët zyrtare, ndërsa në 4 Komuna (Hani Elezit, Skenderaj, Mitrovica e Veriut, Gjilan) nuk publikohen.

Implementimi efektiv i legjislacionit për trashëgiminë kulturore ka qenë pjesë e angazhimeve të vazhdueshme të organeve komunale. Sipas të dhënave, Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore e kanë hartuar vetëm 10 komuna (*Shtërpcë, Prizren, Deçan, Dragash, Prishtinë, Graçanicë, Kaçanik, Viti, Obiliq, Rahovec*). Në mungesë të stafit profesional, mjeteve buxhetore, sfidat lidhur me regjistrimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore ekzistuese, 21 komuna (*Pejë, Junik, Glogoc, Malishevë, Podujevë, Partesh, Ranillug, Ferizaj, Suharekë, Novobërdë, Mitrovicë Jugore, Hani Elezit, Skenderaj, Shtime, Gjilan, Vushtrri, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë Veriore dhe Klinë*) nuk e kanë miratuar këtë Plan.

Gjatë kësaj periudhe numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura në 4 Komuna (*Shtërpcë, Prizren, Mitrovicë Jugore, Lipjan*) është 19 shkelje.

Gjithashtu me qëllim për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore komunat kanë ndërmarrë aktivitetet të ndryshme. Në 22 Komuna (*Pejë, Junik, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Mitrovicë Jugore, Malishevë, Podujevë, Viti, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë*) janë realizuar këto aktivitete: *Promovimi i aseteve të trashëgimisë në media televizive, postimet e fotografive nga asetet e trashëgimisë kulturore, hartimi i hartave zonale dhe shpërndarja e broshurave për promovim të turizmit, vetëdijësi i qytetarëve, është bërë projekti për restaurimin e disa objekteve të trashëgimisë kulturore, mbështetje e projekteve dhe të individëve, festivale folklorike, aktivitete edukative, kulturore, vizita në muzeume dhe në objektet që janë nën mbrojtje, promovime të ndryshme, etj.* Ndërsa në 9 komuna (*Shtërpcë, Dragash, Hani Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Shtime, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë*) nuk ka pasur aktivitete gjatë kësaj periudhe të raportimi.

Po ashtu, 12 komuna (*Pejë, Junik, Shtërpcë, Prizren, Deçan, Klinë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë*) kanë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të objekteve të trashëgimisë kulturore, në 10 Komuna (*Dragash, Kaçanik, Mitrovicë Jugore, Prizren, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Podujevë, Viti, Novobërdë, Kamenicë*) janë siguruar pjesërisht, dhe në 9 komuna (*Glogoc, Shtime, Malishevë, Partesh, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Partesh, Vushtrri, Hani i Elezit*) nuk janë siguruar pajisjet për monitorim të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Në 5 komuna (*Shtërpcë, Klinë, Partesh, Ferizaj, Fushë Kosovë*) janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse. Në 20 Komuna tjera nuk janë nënshkruar sepse disa prej tyre nuk kanë kisha.

Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar- Dhjetor 2024 komuna e Prizrenit nuk ka alokuar buxhet, ka pasur 3 ndërtime ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit, prej tyre 1 ndërtim, 1 rrënim dhe 1 renovim. Ndërsa komuna e Rahovecit ka themeluar Këshillin e fshatit për Hoqën e Madhe, për të cilin ka ndarë buxhet në vlerë prej 30.670 për vitin 2025, për të mundësuar funksionimin e tij.

Kriteret ekonomike

Zhvillimi ekonomik mbetet një nga prioritetet kryesore në nivel vendi. Politikat ekonomike përbëjnë substancën programore pothuajse të të gjithë mekanizmave të administratës shtetërore, përfshirë këtu komunat të cilat kanë një rol të padiskutueshëm në këtë drejtim.

Sa i përket aktiviteteve konkrete të parapara në planet e komunave të kësaj fushë, gjatë vitit 2024 në 28 komuna janë krijuar kushte të nevojshme për funksionimin e qendrave one-stop-shop, të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese, përfshirë regjistrimin e tyre. Megjithatë, janë edhe 3 komuna (*Prishtinë, Ranillug, Partesh*) të cilat ende nuk i kanë funksionalizuar qendrat për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et). Numri i inspektorëve të tregut në 25 komuna është 33, ndërsa janë 6 Komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prishtinë, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë) që nuk kanë inspektor.

Sa i përket planifikimit të pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal, janë 25 komuna të cilat kanë publikuar regjistrin e pronës komunale, ndërsa në 6 komuna (Prizren, Deçan, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Obiliq, Graçanicë) nuk është publikuar. Po ashtu në 11 komuna është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, ndërsa në 20 Komuna (Pejë, Prizren, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Shtime, Malishevë, Podujevë, Ranillug, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Novobërdë, Fushë Kosovë, Graçanicë) nuk është bërë ende funksionalizimi i zonave ekonomike.

Komunat po ashtu, janë koncentruar edhe në përmirësimin e menaxhimit të financave publike, ngase sfida mbetet sidomos shpenzimi i mjeteve buxhetore në kategorinë e shpenzimeve kapitale. Zbatimi i rekomandimeve të auditorit ndikon në përmirësimin e menaxhimit të financave publike për një performancë sa më të mirë dhe shërbime më të mira ndaj qytetarëve. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, nga 31 komuna raportuese 25 prej tyre kanë pranuar 233 rekomandime nga Auditori i Përgjithshëm. Prej tyre të adresuar janë 173 rekomandime, të pa adresuara mbesin 80 rekomandime dhe pjesa tjetër gjenden në proces. Njësia e Auditimit të Brendshëm është e funksionalizuar në 26 komuna, ndërsa në 5 komuna (*Mitrovicë Veriore, Partesh, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranillug*) nuk funksionon. Poashtu në 24 Komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Kamenicë) është themeluar komiteti për auditim, ndërsa në 7 Komuna (Partesh, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë, Hani i Elezit dhe Ranillug) nuk është themeluar.

Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit në 27 komuna janë mbajtur 187 dëgjime publike, kurse në 3 komuna (Pejë, Graçanicë, Shtime) nuk janë mbajtur, ndërsa në 1 komunë (Hani i Elezit) nuk është ofruar përgjigje.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 numri i bizneseve të regjistruara në 27 Komuna është 6951, ndërsa numri i bizneseve të mbyllura në 27 Komuna është 522. Vlen të theksohet se një ndër aktivitetet të cilat kanë rëndësi në Agjendën Evropiane është edhe mbështetja e Grave në udhëheqjen e bizneseve, e që gjatë vitit 2024 numri i bizneseve të udhëhequra nga gratë në 26 Komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Klinë, Kaçanik, Hani Elezit, Skenderaj, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Suhareka, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenica) është 4398, ndërsa në 5 Komuna (Prishtinë, Obiliq, Novobërdë, Graçanicë dhe Viti) nuk ka biznese të udhëhequra nga gratë. Buxheti i ndarë në 12 Komuna për subvencionimin e bizneseve është 797,200.00 euro, ndërsa në 19 Komuna nuk kanë ndarë buxhet për subvencionimin e bizneseve gjatë periudhës raportuese.

Standardet Evropiane

Komponentë kryesore e zhvillimit ekonomik lokal mbetet sektori i bujqësisë, përkatësisht zbatimi i duhur dhe efektiv i politikave të cilat janë thelbësore për funksionimin e politikave të përbashkëta bujqësore evropiane. Nga gjithsej 31 komuna raportuese, vetëm 11 komuna (*Junik, Prizren, Glllogoc, Rahovec, Dragash, Hani i Elezit, Malishevë, Podujevë, Partesh, Ferizaj, Kamenicë*) kanë hartuar Plan Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.


Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural në 22 komuna (*Pejë, Junik, Glllogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Mitrovicë Jug, Viti, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë*) janë të funksionalizuara qendrat informative, ndërsa në 9 komuna (*Shtërpcë, Prizren, Hani i Elezit, Shtime, Malishevë, Podujevë, Ranillug, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut*) ende nuk janë funksionalizuar. Janë 22 komuna të cilat kanë ofruar mbështetje për 7889 fermerë për kultivimin e bujqësisë në sektorë të: *blegtorisë, hortikulturës, perimtarisë, shpeztarisë*, etj, ndërsa 6 komuna (*Shtërpcë, Deçan, Novobërdë, Lipjan, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut*) gjatë këtij viti nuk kanë ofruar mbështetje për fermerët.

Planin për Menaxhimin e tokave rurale e posedojnë 16 Komuna (*Pejë, Dragash, Hani Elezit, Graçanicë, Shtime, Podujevë, Viti, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë*), ndërsa 15 komuna tjera ende nuk është hartuar ky plan.

Një numër i aktiviteteve janë zhvilluar edhe në fushën e energjisë eficiente. Planin për energji eficiente është hartuar në 17 komuna. Duhet marrë veprime që këto plane të hartohen edhe në 16 komuna (*Pejë, Junik, Shtërpcë, Prizren, Glllogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Malishevë, Viti, Partesh, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan*). Me qëllim të zbatimit të këtij plani, në 21 komuna (*Pejë, Junik, Shtërpcë, Prizren, Glllogoc, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Mitrovicë Jug, Malishevë, Podujevë, Viti, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Kamenicë*) ka pasur projekte në masat e zbatimit të efijencës. Disa nga projektet janë: vendosja e poqeve efijente në qytet dhe në fshatra, izolimi i objekteve arsimore dhe objekteve të tjera publike me masat për efijencë të energjisë, ndërimi i trupave ndriçuese me trupa efijentë – LED, ndërtimi i sistemeve të reja të ngrohjes qendrore nëpër objektet publike etj. Në 10 komuna (*Deçan, Hani i Elezit, Graçanicë, Shtime, Ranillug, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Vushtrri, Novobërdë, Fushë Kosovë*) nuk ka pasur asnjë projekt.

Në kuadër të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi komunat janë të obliguar të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij ligji dhe sipas të dhënave zyrtare mund të shohim se deri më tani 25 komuna kanë caktuar zyrtarin për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa 6 komuna (*Kaçanik, Viti, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Obiliq, Novobërdë*) ende nuk e kanë caktuar.

Kurse zyrtari për barazi gjinore është caktuar në 27 komuna (*Pejë, Junik, Shtërpcë, Prizren, Glllogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë*), ndërsa në 4 (*Kaçanik, Ranillug, Obiliq, Novobërdë*) ende nuk është caktuar.



Diagrami 11: Mekanizmat lokal për zbatimin e ligjit kundër diskriminimit.

Një ndër sfidat e evidentuara nga raporti i KE-së për Kosovën për nivelin lokal e cila mbetet si një çështje serioze është kujdesi për të moshuarit. Nga të dhënat e ofruara rezultoi se në 10 komuna (Pejë, Rahovec, Prishtinë, Skenderaj, Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Novobërdë, Lipjan) ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit, ndërsa 21 komuna (Junik, Shtërpçë, Prizren, Glllogoc, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Malishevë, Podujevë, Viti, Ranillug, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Obiliq, Fushë Kosovë, Kamenicë, Hani i Elezit) nuk ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit.

Sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë secila komunë, përmes drejtorisë të saj përkatëse, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj sipas standardit të specifikuar nga Ministria. Gjithashtu në 12 komuna (Pejë, Prizren, Rahovec, Prishtinë, Skenderaj, Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan) gjenden 13 qendra për të moshuarit.

Një tjetër e gjetur nga raporti i KE-së për Kosovën ka qenë edhe hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër dhunës në familje, e cila strategji në bazë të raportimeve është hartuar në 19 komuna (Pejë, Junik, Prizren, Rahovec, Dragash, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Mitrovicë Jugore, Shtime, Malishevë, Podujevë, Gjilan, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë). Në 24 komuna janë paraqitur 1080 raste të dhunës, kurse në 5 komuna (Pejë, Partesh, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Hani i Elezit) nuk ka pasur raste të paraqitura të dhunës. Në përgjithësi komunat kanë raportuar që ndaj rasteve të paraqitura kanë ndërmarr veprime dhe kanë ofruar mbështetje. Ndërsa për rritjen e vetëdijesimit të publikut për dhunën në familje janë 25 komuna të cilat kanë ndërmarr masa/veprime ndaj viktimave të dhunës në familje konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje si: *vetëdijesimi i qytetarëve mbi pasojat e dhunës në familje, këshillime sociale, fushata vetëdijesuese, trajnime, broshura të shpërndara për vetëdijesimin kundër dhunës*, etj. Në 6 komuna (Rahovec, Ranillug, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Hani i Elezit) nuk është ndërmarr asnjë masë.

Sa i përket themelimit të këshillit komunal për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në baza gjinore, në 19 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glllogoc, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Viti, Partesh, Ferizaj, Suharekë, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë) është themeluar ky këshill dhe janë mbajtur 18

takime. ndërsa në 12 komuna (Deçan, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Podujevë, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Obiliq, Vushtrri, Kamenicë, Hani i Elezit) nuk janë themeluar ende.

Janë bërë përpjekje të vazhdueshme nga komunat për të përkrahur zbatimin e politikave gjinore, ku në 29 komuna numri i grave në pozita menaxheriale është 1002. Krahas tyre, në administratën publike lokale duke përfshirë edhe kuvendin e komunës në 30 komuna, janë të përfshira 4112 gra. Sa i përket raportit statistikor (gjinor) të drejtorëve të drejtorive komunale, në 27 komuna numri i drejtoreshave komunale është 95 ndërsa 4 Komuna (Klinë, Ranillug, Partesh, Novobërdë) nuk ka asnjë drejtoreshë.

Prona në emër të dy bashkëshortëve në 26 komuna janë të regjistruar 5898 ndërsa në 5 komuna (Pejë, Shtërpçë, Dragash, Hani i Elezit, Mitrovicë e Veriut) nuk ka pasur prona të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve.

Sfidë tjetër e identifikuar nga raporti i Komisionit Evropian për nivelin lokal të qeverisjes është edhe zbatimi i ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, gjë për të cilat një numër i konsiderueshëm i komunave kanë shfaqur sfidat dhe vështirësitë e tyre në zbatimin e këtij ligji si: *mungesa e mjeteve financiare, mungesa e stafit profesional, numri i ulët i dëgjimeve publike, mungesa e Themelimit të Ekipit për Mbrojtjen e fëmijës, Mungesa e hartimit të udhëzimeve administrative të cilat parashihen në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, mungesa e Grantit Specifik për Qendrat për Punë Sociale në Ligjin për Buxhet i cili grant do t'ju mundësonte QPS-ve buxhetim të mjaftueshëm për ushtrim të rregullt të veprimtarive të tyre, mungesa e përkrahjes logjistike si vendstrehimet etj.* Në 23 komuna janë caktuar zyrtarët përkatës për mbrojtjen e fëmijëve, ndërsa në 7 komuna (Shtërpçë, Glogoc, Skenderaj, Viti, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë) ende nuk janë caktuar këta zyrtar. Për rritjen e vetëdijesimit mbi këtë ligj në 23 komuna janë organizuar fushata/takime vetëdijësuese me qytetarët ndërsa 8 komuna (Shtërpçë, Dragash, Klinë, Graçanicë, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Suharekë, Hani i Elezit) nuk kanë zhvilluar asnjë fushatë.

Në kuadër të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve sfidë vazhdon të mbetet edhe aksesit i duhur i fëmijëve me aftësi të kufizuara në objektet arsimore si dhe asistencën e nevojshme. Në këtë aspekt gjatë periudhës raportuese nga 19 komuna (Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Viti, Ranillug, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Lipjan, Kamenicë, Fushë Kosovë) është raportuar se objektet arsimore janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, në 8 komuna (Dragash, Prishtinë, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Vushtrri, Novobërdë) janë të qasshme pjesërisht, si dhe në 4 Komuna (Pejë, Obiliq, Hani i Elezit, Mitrovicë Veriore) nuk janë të qasshme. Gjithashtu në 26 komuna (Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Malishevë, Podujevë, Viti, Ranillug, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) kanë asistencën e duhur në mësim personat me aftësi të kufizuara, në 5 komuna nuk kanë asistencën e duhur.

Në 22 komuna (Pejë, Junik, Prizren, Glogoc, Deçan, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë) është ofruar përkujdesje për fëmijët pa përkujdesje prindërore, në 9 Komuna (Shtërpçë, Partesh, Klokot, Ranillug, Novobërdë, Shtime, Vushtrri, Hani i Elezit dhe Ranillug) nuk ofrohet përkujdesje.

Për fuqizimin e nivelit lokal në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në 16 komuna (Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Klinë, Kaçanik, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë) është i miratuar Plani tre-vjeçar për strehim social, derisa janë 15 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Dragash,

Prishtinë, Skenderaj, Viti, Ranillug, Partesh, Mitrovice Veriore, Vushtrri, Novobërdë, Suharekë, Kamenicë dhe Hani i Elezit) të cilat ende nuk kanë hartuar këtë plan.

Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar është funksionalizuar në 17 komuna, ndërsa në 13 komuna (Shtërpcë, Prizren, Deçan, Dragash, Prishtinë, Kaçanik, Skenderaj, Podujevë, Ranillug, Partesh, Mitrovice e Veriut, Vushtrri, Novobërdë dhe Hani Elezit) nuk është themeluar. Sa i përket ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në 7 regjione (*Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë*) është funksionalizuar Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas. Ndërsa zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike, janë themeluar në 18 komuna (*Pejë, Junik, Prizren, Glllogoc, Rahovec, Dragash, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Shtime, Malishevë, Podujevë, Partesh, Gjilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Kamenicë*), ndërsa në 5 Komuna (*Shtërpcë, Ranillug, Mitrovicë Veriore, Ferizaj, Mitrovicë Veriore*). Numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në 16 komuna është 3305 dhe në 2 Komuna (*Mitrovicë Jugore dhe Pejë*), nuk kanë pasur kërkesa.

Për zbatimin e Strategjisë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, në 18 është themeluar komiteti lokal ndërsa , në 6 Komuna (Skenderaj, Malishevë, Viti, Mitrovicë Veriore, Graçanicë dhe Prishtinë) nuk është themeluar nuk është themeluar. Ndërsa 7 Komuna (Glllogoc, Junik, Dragash, Shtërpcë, Kaçanik, Hani i Elezit, Ranillug) nuk kanë komunitete rom, ashkali dhe egjiptian.

Në 17 komuna (*Prizren, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Mitrovicë Jug, Shtime, Podujevë, Viti, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suhareke, Novobërdë, Lipjan, Kamenice*) është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ndërsa në 9 komuna (*Pejë, Junik, Shtërpcë, Deçan, Skenderaj, Graçanicë, Malishevë, Gjilan, Fushë Kosovë*) ende nuk është miratuar ky plan, si dhe në 5 komuna (*Glllogoc, Dragash, Kaçanik, Hani i Elezit, Ranillug*) nuk kanë komunitete rom, ashkali dhe egjiptian.

Për realizmin e fushatave për regjistrim falas të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në 19 komuna janë realizuar fushata për regjistrim, ndërsa në 7 komuna (*Pejë, Shtërpcë, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Gjilan, Suhareke, Novobërdë*) nuk është realizuar ndonjë fushatë, si dhe 5 komuna (Glllogoc, Dragash, Kaçanik, Hani i Elezit, Ranillug) nuk kanë komunitete rom, ashkali dhe egjiptian.

Një ndër sfidat e raportit të KE-së për Kosovën është edhe hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Riintegrim për të cilin plan janë 27 komuna që kanë arrit ta hartojnë ndërsa në 4 komuna (*Shtërpcë, Skenderaj, Mitrovicë Veriore, Fushë Kosovë*) ende nuk e kanë hartuar. Në 27 komuna (*Pejë, Junik, Shtërpcë, Prizren, Glllogoc, Deçan, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Mitrovicë Jugore, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suhareke, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë*) është themeluar Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR), ndërsa në 4 Komuna (Rahovec, Graçanicë, Ranillug, Fushë Kosovë) nuk është themeluar.

Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur, dhe përkrahja nga niveli lokal ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe. Në 15 komuna (Pejë, Glllogoc, Dragash, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Malishevë, Viti, Ranillug, Partesh, Gjilan, Obiliq, Suhareke, Lipjan, Kamenicë) numri i personave të zhvendosur është 187 persona, ndërsa në 16 komuna (Junik, Shtërpcë, Prizren, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Mitrovicë Jugore, Shtime, Podujevë, Ferizaj, Vushtrri, Novobërdë, Fushë Kosovë, Hani Elezit dhe Mitrovicë e Veriut) nuk ka pasur asnjë person të zhvendosur.

Sa i përket aplikimit për asistencë nga fondi për ri-integrim në 17 komuna (Pejë, Glogoc, Prishtinë, Klinë, Graçanicë, Mitrovica Jugore, Malishevë, Podujevë, Viti, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) numri i aplikimeve është 169, ndërsa numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar në 11 komuna (Glogoc, Prishtinë, Malishevë, Podujevë, Viti, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë) është 124.

Komunat janë përgjegjëse për ofrimin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të mësimdhënësve në kuadër të arsimit gjithëpërfshirës, 21 komuna kanë organizuar 331 trajnime, në 9 komuna (*Junik, Shtërpce, Dragash, Viti, Ranillug, Partesh, Vushtrri, Hani i Elezit, Graçanicë*) nuk është mbajtur asnjë trajnim, ndërsa komuna e Mitrovicës së Veriut për shkak të rrethanave politike nuk ka mundur të mbajë trajnime. Në 27 komuna janë 125 çerdhe funksionale.

Sa i përket rritjes së nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor, në 27 komuna numri i fëmijëve të moshës 0-5 vjeç që ndjekin arsimimin dhe kujdesin e fëmijërisë së hershme është 10738 fëmijë. Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në çerdhe në 17 komuna është 215.

Çështja e braktisjes së shkollimit nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian ka qenë e evidente ndër vite. Sipas të dhënave numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në 9 komuna (*Pejë, Deçan, Prishtinë, Skenderaj, Shtime, Podujevë, Ferizaj, Lipjan, Fushë Kosovë*) është 118.

Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mos regjistrimit të shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali) është i hartuar vetëm në 10 komuna (*Prizren, Deçan, Mitrovicë Jugore, Shtime, Malishevë, Podujevë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Lipjan*). Janë 23 komuna (Glogoc, Suharekë, Deçan, Pejë, Podujevë, Skenderaj, Klinë, Dragash, Shtërpce, Kaçanik, Kamenicë, Malishevë, Rahovec, Shtime, Lipjan, Fushë Kosovë, Gjakovë, Mitrovicë e Jugut, Prishtinë, Prizren, Gjilan, Viti, Ferizaj) të cilat kanë formuar ekipet vepruese për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla. Lidhur me këtë janë 7 komuna (Prizren, Podujevë, Ferizaj, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) që kanë zhvilluar: trajnime, projekte dhe fushata vetëdijësuese me prindërit mbi rendësin e nevojës së shkollimit të fëmijëve të këtij komuniteti me qëllim të sensibilizimit të nevojës së shkollimit të fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, ndërsa në 20 komuna nuk është zhvilluar ndonjë trajnim.

Komunat përballen me vështirësi të shumta në fushën e mjedisit, problemin e mbeturinave, ndotjen e ajrit dhe deponitë e parregullta. Me qëllim të zbatimit Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, 28 komuna (Pejë, Junik, Shtërpce, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Klinë, Kaçanik, Hani Elezit, Skenderaj, Mitrovicë Jugore, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Ranillug, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suhareke, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) kanë hartuar Planin për menaxhimin e mbeturinave *ndërsa 3 komuna tjera* ende nuk kanë hartuar këtë plan. Me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit, në 21 komuna janë zhvilluar 56 fushata. Numri i deponive ilegale në 26 komuna është 495, ndërsa në 5 komuna (*Junik, Prishtinë, Hani Elezit, Graçanicë, Mitrovica e Veriut*) kanë raportuar që nuk ka deponi ilegale.

Hartimi i planit të veprimit për cilësinë e ajrit mbetet sfida e theksuar e komunave ku vetëm 5 komuna (*Glogoc, Deçan, Kaçanik, Vushtrri, Fushë Kosovë*) e kanë hartuar këtë plan.

Në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës, janë 19 komuna që kanë organizuar fushata ndërsa në 12 komuna (*Junik, Shtërpçë, Prizren, Deçan, Skenderaj, Shtime, Ranillug, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Hani i Elezit dhe Vushtrri*) nuk ka pasur asnjë fushatë.

FINANCAT LOKALE

Burimet financiare komunale kërkohet të jenë të barasvlershme me kompetencat komunale të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Burimet financiare të një komune përbëhen nga: të hyrat vetanake të komunës, grantet operative, grantet për kompetencat e shtuara, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme dhe të hyrat nga huamarrjet e komunës. Të hyrat vetanake komunale janë mjetet financiare që mbliidhen nga: taksat, tarifat, gjobat, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, të hyrat nga ndërmarrjet komunale, bashkëpagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj. Në këtë pjesë të raportit pasqyrohen të dhëna të rëndësishme për planifikimin e të hyrave vetanake të komunave për vitin 2022, si dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimet e buxheteve komunale në tërësi.

Planifikimi i të hyrave vetanake

Për vitin 2024, planifikimi i të hyrave vetanake është në vlerë prej 105,523,577.00€, ku krahasuar me të hyrat e planifikuara për vitin 2023, në vlerë prej 98,519,261.00€, del që planifikimi për vitin 2024 ka qenë më i lartë për 7,004,316.00€, ose shprehur në përqindje 7.10%.

Gjithashtu realizimi i të hyrave për vitin 2024 prej 99,583,078.74 €, krahasuar me planifikimin prej 105,523,577.00€ ka një ulje prej 5.63 % krahasuar me vitin 2023 që realizimi kishte rritje prej 11.36%.

Realizimi i të hyrave vetanake

Komunat i mbledhin të hyrat vetanake në dy forma: a) të hyra të mbledhura drejtpërdrejt nga komuna (të hyra direkte) dhe b) të hyrat të arkëtuara nga niveli qendror (të hyrat indirekte), të cilat transferohen në komuna si pjesë përbërëse e të hyrave vetanake

Realizimi i të hyrave direkte dhe indirekte për vitin 2024 ka arritur vlerën prej 120,457,860.29 €, prej të cilave 99,583,078.74 € kanë qenë të hyra direkte dhe 20,874,781.55€ kanë qenë të hyra indirekte. Nëse kjo vlerë krahasohet me vlerën totale të planifikuar, në shumën prej 105,523,577.00€, atëherë shohim që realizimi ka arritur nivelin prej 114.15 %.

Inkasimi i të hyrave vetanake direkte për vitin 2024 në vlerë prej 99,583,078.74 € krahasuar me inkasimin e të hyrave të llojit të njëjtë për vitin 2023 në vlerë prej 109,713,354.71€, është më i ulët prej 10,130,274.97 €, apo 9.23%.

Në bazë të përqindjes së inkasimit të të hyrave vetanake, komunat që kanë nivel më të lartë të realizimit janë si vijon: Glllogoc 110.14%, Fushë Kosovë 108.74%, Lipjan 123.85%, Podujevë 92.01%, Shtime 97.96%, Graçanicë 109.92%, Dragash 95.23%, Rahovec 115.37%, Suharekë 109.08%, Malishevë 208.07%, Mamushë 116.46%, Deçan 102.79%, Gjakovë 115.28%, Istog 147.56%, Pejë 99.52%, Skenderaj 121.48%, Mitrovicë Veriore 110.66%, Novobërdë 159.07%,

Ferizaj 114.51%, Viti 91.41%, Partesh 154.30%, Hani i Elezit 92.40%, Ranillug 122.58%. Ndërsa përqindjen me të ulët të realizimit të të hyrave kanë komunat si: Leposaviq 10.79%, Zubin Potok 6.64%, Zveçan 11.17%.

Komunat të cilat kanë treguar realizim mesatar të inkasimit janë: Obiliq 73.10%, Prishtinë 83.54%, Prizren 82.52%, Klinë 89.80%, Junik 75.37%, Mitrovicë 82.43%, Vushtrri 87.23%, Gjiilan 86.68%, Kaçanik 80.49%, Kamenicë 72.94%, Shtërpçë 80.77%, Klllokot 64.23%.

Të hyrat që kanë një ndikim më të madh në rritjen e të hyrave vetanake janë tatimi në pronë i cili gjatë vitit 2024 është inkasuar në shumën prej 33,014,454.57€, një lloj tjetër i të hyrave që ka ndikim në rritjen e të hyrave vetanake janë edhe të hyrat komunale për leje ndërtimi për ku për periudhën raportuese janë inkasuar shuma prej 31,365,351.76€.

